



REPUBLIKA E KOSOVES
REPUBLIC OF KOSOVO
REPUBLIKA KOSOVO
OPŠTINA LIPLJAN

Pranuar me: Primljeno: 13.01.2025		
Njësia Jednica	Numri Broj	Shtojca Dodatak
05-020/04-2280		



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të nenit 62 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr.28 e datës 4 qershor 2008, Nenit 8 të Rregullores mbi kriteret, standartet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve nr. MF04/2017 si dhe nenit 51 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15Nr. 110-78095 i datës 24.12.2021, Drejtoresha e DKRS shpallë:

**NJOFTIM PUBLIK
PËR DËRGIMIN E PROPOZIMEVE PËR ANËTAR NË KOMISIONIN VLERËSUES PËR
FINANCIMIN E PROJEKTEVE TË OJQ-VE**

Njoftohen përfaqësuesit e Organizatave të shoqërisë civile se mund ti dërgojnë propozimet e tyre për plotësimin e Komisionit Vlerësues i cili do të formohet më qëllim të vlerësimit të aplikacioneve të financimit të projekteve, të OJQ-ve të cilat do të aplikojnë sipas thirrjes publike për aplikim me Nr.05-453/01-1148 të datës 08.01.2025

Ky Komision do të formohet me qëllim të vlerësimit të aplikacioneve për financimin e projekteve që kontribuojnë në Kulturë dhe Sport në Komunën e Lipjanit, sipas thirrjes publike për aplikim të Nr.05-453/01-1148 të datës 08.01.2025 ku do të plotësohet me:

- Një përfaqësues nga OJQ-të
- Një përfaqësues nga shoqëria civile në cilësinë e ekspertit

Propozimet tuaja do të jenë të mirëpritura dhe duhet t'i drejtohen Drejtoratit për Kulturë, Rini dhe Sport dhe të njëjtat të dorëzohen në ndërtesën e Komunës kati I në Qendrën për shërbime me qytetar sporteli nr. 1 dhe 2 më së largu deri me datë **21/01/2025**.

Lipjan, më 13.01.2025

Anila Reçica-Llugiqi
Drejtoresha e DKRS-së

